

VENDIM
Nr. 55, datë 2.5.2012

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHITBLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS
SHOQËRISË KESH SHA DHE SHOQËRISË “HEC ULËZ – SHKOPET” SHA**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 4 të modelit të tregut shqiptar të energjisë elektrike miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë “Hec Ulëz - Shkopet” sh.a.,

konstatoi se:

- Shoqëria KESH sh.a. është licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 11, datë 23.6.2006, të ndryshuar.

- Shoqëria “Hec Ulëz-Shkopet” është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe me vendimin nr. 133, datë 6.12.2011 është licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, modelin shqiptar të tregut të energjisë miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe me vendimin e ERE-s nr. 154, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec Ulëz-Shkopet” për periudhën e tretë rregullatore”.

- Modeli i tregut e vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës me nr. 1259, prot., datë 23.3.2012 të shitblerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë “Hec Ulëz - Shkopet” sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani